

URDHËR
Nr. 191, datë 8.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 8046, DATË 2.12.2004 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR KUSHTET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË ZYRË NOTERIALE PËR TË MUNDËSUAR USHTRIMIN NORMAL TË VEPRIMTARISË SË NOTERIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pika 4 e urdhrit nr. 8046, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Zyra e noterit duhet të jetë me sipërfaqe të mjaftueshme për të lejuar ushtrimin normal të veprimtarisë së tij, por në çdo rast jo më e vogël se 20 m², dhe të jetë e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin nga ndikimi i agjentëve atmosferikë (si lagështia, pluhuri, dielli etj.) dhe nga zjarri.”.

2. Ngarkohen noterët të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 4, brenda datës 1.9.2013. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje disiplinore dhe passjell fillimin e ecurisë disiplinore ndaj noterit.

3. Struktura përgjegjëse për veprimtarinë noteriale në Ministrinë e Drejtësisë, brenda datës 15.9.2013, ushtron kontrolle në të gjitha zyrat noteriale dhe i paraqet raport kontrolli Ministrit të Drejtësisë për përmbushjen nga noterët të detyrimit mbi plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 4.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi